**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada – Government*

---

# UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 09/2021 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (QRK) NR. 03/2015 PËR VLERËSIM TË NDIKIMIT BUXHETOR PËR NISMAT E REJA QEVERITARE[1]

# ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) NO. 09/2021 ON AMENDING AND SUPPLEMENTING THE ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) NO. 03/2015 ON BUDGET IMPACT ASSESSMENT FOR NEW GOVERNMENT INITIATIVES[2]

# AMINISTRATIVNO UPUTSTVO (VRK) BR. 09/2021 O DOPUNI I IZMENI ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA (VRK) BR. 03/2015 O PROCENI UTICAJA NA BUDŽET ZA NOVE VLADINE INICIJATIVE[3]

---

[1] Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 09/2021 për Potësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 03/2015 për Vlerësim të Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare, është miratuar në Mbledhjen e 47-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 12/47 të dt. 10.12.2021.
[2] Administrative Instruction (GRK) - No. 09/2021 on Amending and Supplementing the Administrative Instruction (GRK) no. 03/2015 on Budget Impact Assessment for New Government Initiatives, was approved on the 47th meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No. 12/47, dated 10.12.2021.
[3] Administrativno uputstvo (VRK) - Br. 09/2021 o Dopuni i Izmeni Administrativnog Uputstva (VRK) br. 03/2015 o Proceni Uticaja na Budžet za Nove Vladine Inicijative, usvojen je na 47 sednicu Vlade Kosova, sa odlukom br. 12/47, datum 10.12.2021.

| Qeveria e Republikës së Kosovës, | Government of Republic of Kosovo, | Vlada Republike Kosova, |
| --- | --- | --- |
| Në mbështetje të nenit 93, paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 26 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (GZ, Nr. 27, 03 Qershor 2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, si dhe nenin 19 (6.2) të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, (GZ, Nr.15, 12 Shtator 2011), | Pursuant to Article 93, paragraph 4 of the Constitution of the Republic of Kosovo, in accordance with Article 26 of Law No. 03/L-048 on Public Financial Management and Accountability (OG, No. 27, June 03, 2008), supplemented and amended by Law No. 03/L-221, Law No. 04/L-116, with Law No. 04/L-194, with Law No. 05/L-063, with Law No. 05/L-007, as well as Article 19 (6.2) of Regulation No. 09/2011 of the Government of the Republic of Kosovo, (OG, No.15, September 12 2011), | Na osnovu člana 93. stav 4. Ustava Republike Kosovo, u skladu sa članom 26. Zakona br. 03 / L-048 o upravljanju javnim finansijama i odgovornosti (SL, br. 27, 3. jun 2008.god), dopunjen i izmenjen Zakonom br. 03 / L-221, Zakonom br. 04 / L-116, Zakonom br. 04 / L-194, Zakonom br. 05 / L-063, Zakonom br. 05 / L-007, kao i člana 19 (6.2) Poslovnika o radu Vlade Republike Kosovo br. 09/2011 (SL, br.15, 12. septembar 2011. godine), |
| **Nxjerr:** | **Issues:** | **Donosi:** |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 09/2021 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (QRK) NR. 03/2015 PËR VLERËSIM TË NDIKIMIT BUXHETOR PËR NISMAT E REJA QEVERITARE** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) NO. 09/2021 ON AMENDING AND SUPPLEMENTING THE ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) NO. 03/2015 ON BUDGET IMPACT ASSESSMENT FOR NEW GOVERNMENT INITIATIVES** | **ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA (VRK) BR. 09/2021 O IZMENAMA I DOPUNAMA ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA (VRK) BR. 03/2015 O PROCENI UTICAJA NA BUDŽET ZA NOVE VLADINE INICIJATIVE** |

| Neni 1<br>Qëllimi | Article 1<br>Purpose | Član 1<br>Svrha |
| --- | --- | --- |
| Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2015 për Vlerësim të Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare (këtej e tutje referuar si “Udhëzimi bazë”). | This Administrative Instruction aims to amend and supplement the Administrative Instruction (GRK) No. 03/2015 on Budget Impact Assessment for New Government Initiatives (hereinafter referred to as the “Basic Guideline”). | Ovo Administrativno uputstvo ima za cilj izmenu i dopunu Administrativnog uputstva (VRK) br. 03/2015 o proceni uticaja na budžet za novre vladine inicijative (u daljem tekstu „Osnovno uputstvo“). |
| **Neni 2** | **Article 2** | **Član 2** |
| Në nenin 17 të Udhëzimit bazë, shtohen paragrafët 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, me tekstin si në vijim: | In Article 17 of the Basic Instruction, paragraphs 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 and 11 are added, with the following text: | U članu 17. Osnovnog uputstva dodaju se stavovi 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10. i 11., koji glase: |
| 3. Përjashtimisht nga dispozitat tjera të këtij Udhëzimi Administrativ, vlerësimi i ndikimit buxhetor për të gjitha nismat e reja që synojnë të rregullojnë skemat apo përfitimet sociale dhe pensionale i nënshtrohen kërkesave për kostim afatgjatë, si në vijim: | 3. Exceptionally to the other provisions of this Administrative Instruction, the budgetary impact assessment for all new initiatives aimed at regulating social and pension schemes or benefits shall be subject to long-term cost requirements, as follows: | 3. Izuzetno od ostalih odredaba ovog Administrativnog uputstva, procene uticaja na budžet za sve nove inicijative koje imaju za cilj regulisanje socijalnih i penzionih šema ili benificija podležu zahtevima za dugoročno obračunavanje, kao što sledi: |
| 3.1. Për nismat që synojnë të rregullojnë skemat apo përfitimet sociale, vlerësimi i ndikimit buxhetor kryhet për një periudhë së paku dhjetë (10) vjeçare; dhe | 3.1. For initiatives aimed at regulating social schemes or benefits, the budget impact assessment is carried out for a period of at least ten (10) years; and | 3.1. Za inicijative koje imaju za cilj regulisanje socijalnih šema ili benificija, procena uticaja na budžet vrši se za period od najmanje deset (10) godina; i |
| 3.2. Për nismat që synojnë të rregullojnë skemat apo përfitimet | 3.2. For initiatives aimed at regulating pension schemes or benefits, the | 3.2. Za inicijative koje imaju za cilj regulisanje penzijskih šema ili |

| | | |
|---|---|---|
| pensionale, vlerësimi i ndikimit buxhetor kryhet për një periudhë së paku pesëdhjetë (50) vjeçare. | budget impact assessment is performed for a period of at least fifty (50) years. | benificija, procena uticaja na budžet vrši se za period od najmanje pedeset (50) godina. |
| 4. Për nisma që synojnë të rregullojnë skemat apo përfitimet sociale, vlerësimi i ndikimit buxhetor realizohet me metodologjinë e përcaktuar me doracakun për vlerësimin e ndikimit buxhtor sipas nenit 5 të Udhëzimit bazë dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni. | 4. For initiatives that aim to regulate schemes or social benefits, the budget impact assessment is carried out with the methodology defined in the manual for budget impact assessment pursuant to Article 5 of the basic guideline and in accordance with the requirements set out in paragraph 3 of this Article. | 4. Za inicijative koje imaju za cilj regulisanje socijalnih šema ili beneficija, procena uticaja na budžet se vrši po metodologiji definisanoj u priručniku za procenu uticaja na budžet prema članu 5. Osnovnog uputstva i u skladu sa zahtevima iz stava 3. ovog člana. |
| 5. Për nismat që synojnë të rregullojnë skemat apo përfitimet pensionale, vlerësimi i ndikimit buxhetor realizohet sipas një metodologjie për kostim afatgjatë të përcaktuar me aneks të veçantë të doracakut për vlerësimin e ndikimit buxhtor të definuar me nenin 5 të Udhëzimit bazë dhe në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, të tilla si, por duke mos u kufizuar vetëm në standardet e vlerësimit dhe metodologjitë e aplikuara nga Bashkimi Evropian, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. | 5. For initiatives aimed at regulating pension schemes or benefits, the budget impact assessment is carried out according to a long-term cost methodology defined by a separate annex to the budget impact assessment manual defined in Article 5 of the Basic Guideline in accordance with the best international practices, such as, but not limited to, the assessment standards and methodologies applied by the European Union, the International Monetary Fund, the Organization for International Cooperation and Development, and the World Bank. | 5. Za inicijative koje imaju za cilj regulisanje penzijskih šema ili beneficija, procena uticaja na budžet vrši se prema metodologiji dugoročnog obračuna koja je navedena u posebnom aneksu priručnika za procenu uticaja na budžet definisan u članu 5. Osnovnog uputstva iu skladu sa najboljim međunarodnim praksama, kao što su, ali ne ograničavajući se na, standarde i metodologije procene koje primenjuju Evropska unija, Međunarodni monetarni fond, Organizacija za međunarodnu saradnju i razvoj i Svetska banka. |
| 6. Aneksi dhe manuali i azhurnuar i vlerësimit të ndikimit buxhetor sipas paragrafit 5 të këtij neni publikohet në web-faqen e Ministrisë përkatëse të | 6. The annex and the updated manual of budget impact assessment pursuant to paragraph 5 of this Article are published on the website of the relevant Ministry of | 6. Aneks i ažurirani priručnik za procenu uticaja na budžet prema stavu 5. ovog člana objavljuju se na veb stranici nadležnog Ministarstva finansija devet (9) meseci |

| | | |
|---|---|---|
| Financave nëntë (9) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ. | Finance nine (9) months after the entry into force of this Administrative Instruction. | nakon stupanja na snagu ovog Administrativnog uputstva. |
| 7. Ministri përkatës i Financave emëron me vendim një task forcë ekspertësh nga stafi i Ministrisë përkatëse të Financave që mbështetë profesionalisht organin propozues për përmbushjen e kërkesave të paragrafëve 3, 4 dhe 5 të këtij neni. | 7. The relevant Minister of Finance appoints by decision a task force of experts from the staff of the relevant Ministry of Finance that professionally supports the proposing body to meet the requirements of paragraphs 3, 4 and 5 of this Article. | 7. Nadležni ministar finansija odlukom imenuje radnu grupu stručnjaka iz osoblja nadležnog ministarstva finansija koja stručno pomaže organu predlagaču za ispunjavanje uslova iz stava 3, 4. i 5. ovog člana. |
| 8. Task forca, sipas paragrafit 7 të këtij neni, harton dhe publikon çdo pesë (5) vjet raport që vlerëson ndikimin afatgjatë buxhetor të skemave ekzistuese pensionale. | 8. The task force, pursuant to paragraph 7 of this Article, drafts and publishes every five (5) years a report that assesses the long-term budget impact of existing pension schemes. | 8. Radna grupa, prema stavu 7. ovog člana, izrađuje i objavljuje svakih pet (5) godina izveštaj koji procenjuje dugoročni uticaj na budžet postojećih penzijskih šema. |
| 9. Me pranimin e vlerësimit të ndikimit buxhetor nga organi propozues në bazë të paragrafit 3, 4, dhe 5 të këtij neni, Departamenti i Buxhetit në Ministrinë përkatëse të Financave shqyrton dokumentet relevante të Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor dhe lëshon opinionin e tij të pavarur tek organi propozues brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune pas pranimit të vlerësimit të ndikimit buxhetor nga organi propozues. | 9. Upon receipt of the budget impact assessment by the proposing body pursuant to paragraphs 3, 4, and 5 of this Article, the Budget Department in the relevant Ministry of Finance reviews the relevant Budget Impact Assessment documents and issues its independent opinion to the proposing body within fifteen (15) working days after receiving the budget impact assessment from the proposing body. | 9. Po prijemu procene uticaja na budžet od organa predlagača u skladu sa stavom 3, 4. i 5. ovog člana, Odeljenje za budžet nadležnog Ministarstva finansija razmatra relevantna dokumenta Procene uticaja na budžet i organu predlagača daje svoje nezavisno mišljenje u roku od petnaest (15) radnih dana nakon prijema procene uticaja na budžet od organa predlagača. |
| 10. Task forca dhe Departamenti i Buxhetit në kuadër të Ministrisë përkatëse të Financave në vazhdimësi trajnohen dhe njoftohen me njohuritë për zhvillimin e vlerësimit afatgjatë të ndikimit buxhetor. | 10. The Task Force and the Budget Department within the relevant Ministry of Finance are continuously trained and informed with the knowledge for the | 10. Radna grupa i Odeljenje za budžet u okviru nadležnog Ministarstva finansija se kontinuirano obučavaju i informišu o znanjima za izradu dugoročne procene uticaja na budžet. |

| | | |
|---|---|---|
| | development of long-term budget impact assessment. | |
| 11. Për të gjitha nismat legjislative të propozuara nga autoritetet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.1, 1.2, dhe 1.4 të paragrafit 1 të nenin 5 të Ligjit përkatës për Nisma Legjislative që synojnë të rregullojnë skemat apo përfitimet sociale dhe pensionale, aplikohet përshtatshmërisht neni 2 i këtij Udhëzimi Administrativ. | 11. For all legislative initiatives proposed by authorities defined in sub-paragraf 1.1, 1.2, and 1.4 of paragraph 1 of Article 5 of the Law on Legislative Initiatives aimed to regulate social and pension schemes or benefits, Article 2 of this Administrative Instruction shall be appropriately applied. | 11. Za sve zakonodavne inicijative, predložene od organa utvrđenim u podstavovima 1.1, 1.2 i 1.4 stava 1 člana 5 relevantnog Zakona o zakonodavnim inicijativama koje imaju za cilj regulisanje socijalnih ili penzionih šema ili beneficija, shodno tome primenjiva se član 2 ovog Administrativnog uputstva. |
| **Neni 3** | **Article 3** | **Član 3** |
| Në nenin 9 të Udhëzimit bazë, shtohet paragrafi 5, me tekstin si në vijim: | In Article 9 of the Basic Guideline, paragraph 5 is added, with the following text: | U članu 9. Osnovnog uputstva dodaje se stav 5. koji glasi: |
| 5. Ministria përkatëse e Financave publikon të gjitha Opinionet e Pavarura të lëshuara pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ. | 5. The relevant Ministry of Finance publishes all Independent Opinions issued after the entry into force of this Administrative Instruction. | 5. Nadležno Ministarstvo finansija objavljuje sva nezavisna mišljenja izdata nakon stupanja na snagu ovog Administrativnog uputstva. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 4**<br>**Hyrja në fuqi**<br><br>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.<br><br>Albin KURTI<br><br>________________________<br><br>**Kryeministër i Republikës së Kosovës**<br><br>13 dhjetor 2021 | **Article 4**<br>**Entry into force**<br><br>This Administrative Instruction enters into force seven (7) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.<br><br>Albin KURTI<br><br>________________________<br><br>**Prime Minister of the Republic of Kosovo**<br><br>13 December 2021 | **Član 4**<br>**Stupanje na snagu**<br><br>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana od dana objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.<br><br>Albin KURTI<br><br>________________________<br><br>**Premijer Republika Kosova**<br><br>13 decembar 2021 |